




Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosovo za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 28/10/2021 Ref.: 3474/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës (Qershor 2020) si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 92-të, të mbajtur më 28 tetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Shëndeti Publik, PhD 180 ECTS, maksimumi 4 studentë për vit akademik;
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë që deri më 15 dhjetorë të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Fakulteti i Mjekësisë, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programit të studimit, me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Shëndeti Publik, PhD 180 ECTS	Tahire Maloku Gjergji Sefedin Mucaj Merita Berisha Isme Humolli Lul Raka

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Mjekësisë me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.


Vizitat janë organizuar më 12.07.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Wolfgang Patsch, Melita Kovacevic, Delia Gologan.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Shëndeti Publik, PhD 180 ECTS,- në shtatë fusha të vlerësimit, plotësohen 36 standarde thelbësore, dhe 10 standarde plotësuese të akreditimit, sipas standardeve të vlerësimit të programeve të doktoratës.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 92 të mbajtur më 28 tetor 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.